



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli 5861/2025

A.nr.858/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.858/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesja H.R, kundër organit të punësimit: Zyra e Rregullatorit për Energji, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragraf 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të datës 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si pabazuar ankesa me numër A.nr.858/2025, e datës 12.05.2025, e parashtruar nga ankuesja H.R.

A r s y e t i m

Ankuesja H.R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 12.05.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të kundër Vendimit A.nr.1467/2024, të datës 29.11.2024, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe vendimeve për caktimin e ushtruesit të detyrues për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Licencimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 20.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Rregullatorit për Energji (tutje ZRRE), ndërsa, kjo e fundit më datë 26.05.2025, ka përcjell provat materiale lidhur me çështjen ankimore, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 3090/2025 të datës 12.05.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën e datës 12.05.2025 nga ankuesja tek Bordi i ZRRE; Plotësimin e ankesës datë 11.05.2025; Vendimin VB-186-2023, i datës 05.07.2023, i Bordit të ZRRE; Procesverbalin e datës 01.07.2024 i Bordit të ZRRE; Vendimin VB-207-2024 i datës 01.07.2024 i Bordit të ZRRE; Procesverbalin e datës 30.09.2024 i Bordit të ZRRE; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 30.09.2024; Vendimin e datës 30.09.2024 për aprovimin e rekomandimit të komisionit vlerësues; Njoftimin e datës 13.01.2025 për anulimin e konkursit për pozitë Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Licencimit; Procesverbalin e datës

12.11.2024 i Bordit të ZRRE; Strukturën organizative të ZRRE; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 26.05.2025; Emailin e datës 24.12.2024 nga Y.F për Ç.Z; Kontratën e punës e datës 11.01.2019 të ankueses; Vendimin me numër protokolli 4378/21024 të datës 25.06.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë rezulton se ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër protokolli 032/19, të datës 11.01.2019, është e punësuar në pozitën *Analiste për Çështje Ligjore dhe Monitorim të Licencave*, në kuadër të ZRRE-së.

Tutje, sipas shkresave të lëndës del së Bordi i ZRRE-së më Vendimin VB-186-023, të datës 05.07.2023, kishte emëruar Y. M i zëvendësues të pozitës së Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe të Licencimit, për një periudhën prej 12 muaj, ndërsa, më datë 01.07.2024, Bordi i ZRRE-së, ka nxjerr Vendimin VB-207-2024, me të cilin ka caktuar sërish Y. M ushtrues të detyrës së Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe të Licencimit dhe atë deri në përfundimin e procesit të rekrutimit. Më datë 07.08.2024, ZRRE-ja ka shpallur konkursin për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit dhe pas përfundimit të procedurës është shpallur kandidati fitues, mirëpo, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së ankueses të datës 01.10.2024, më Vendimin A.nr.1467/2024 të datës 29.11.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës ankuese, duke anuluar në tërësi procedurën e konkurrimit për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit. Në kuptim të zbatimit të Vendimit A.nr.1467/2024, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ZRRE-ja më aktin më numër protokolli 006/25, të datës 13.01.2025 ka anuluar konkursin për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është zbatuar në tërësi Vendimi A.nr.1467/2024 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse, nuk është anuluar kontrata e punës për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit, të lëshuar si rezultat i konkursit të datës 07.08.2024, ndërsa, kjo pozitë po mbahet me ushtrues detyrës nga muaji korrik 2023. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të ndërpritet mandati i ushtruesit të detyrës në këtë pozitë, ndërsa caktimi i ushtruesve të detyrës të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të kompetencës lëndore të Këshillit të përcaktuar me nenin 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thekson faktin së KPMSHCK mandatit të tij lidhur më sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ushtron sipas funksioneve të përcaktuara më nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ku thuhet se: *"1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;...1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil"*

Ndërsa, në kuptim të përcaktimit të statusit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, Kolegji duke u bazuar në shtojcën nr.1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe nenin 1 dhe 2 i Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, ku përcaktohet se: **NENI 1:** *1. Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e*

aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. 2. Ky Ligj është pjesërisht në përputhje me Direktiven 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, Direktiven Nr. 2009/73/EC për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Rregulloren Nr. 715/2009/EC për kushtet e qasjes në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërtishme. **Neni 2 Fushëveprimi. Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga Rregullatori e cila ushtron kompetencat e agjencisë së pavarur si pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, përveç nëse në mënyrë specifike parashihet ndryshe..”** si rrjedhojë ZRRE është agjenci e pavarur shtetërore, kështu që, mbi këtë bazë dhe duke u mbështetura në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të punësuarit në kuadër të këtij institucioni nuk janë përjashtuar nga fushëveprimi i këtij ligji dhe po ashtu nuk janë përjashtuar nga shërbimi civil , kështu që, të njëjtit kanë statusin e nëpunësit civil dhe së marrëdhënia e tyre punës rregullohet sipas legjislacionit të aplikueshëm për zyrtarët publikë.

Referuar konstatimit si me sipër, caktimi i ushtruesve të detyrës në pozitat e lira në ZRRE duhet të bëhet në pajtim me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: Neni 35 (Ligji nr. Nr. 08/L-197 i aplikueshëm nga data 26.09.2023) ka përcaktuar se: Neni 35 [Ushtruesja/i e/i detyrës],. 1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë.2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Neni 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm. Neni 9 (Ligji nr. Nr. 08/L-294, i aplikueshëm nga data 18.06.2025) ka përcaktuar se: 1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari. 2. Paragrafi 3. i nenit 35 të Ligjit bazik riformulohet si vijon: 3. “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”. 3. Paragrafi 4 i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve.

Rrjedhimisht, marrë për bazë kuadrin ligjor si më lartë, Kolegji nuk ka trajtuar ligjshmërinë e Vendimit VB-207-2024 të datës 01.07.2024, të Bordit të ZRRE-së, për caktimin e z. Y.M ushtrues i detyrës së Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Licencimit, për faktin së në kohën e vendosjes sipas ankesës (datë 07.07.2025) akti në fjalë është pa efekt juridik dhe si tillë është i pazbatueshëm, sepse nga data e nxjerrjes se tij (01.07.2024) kanë kaluar më shumë së 1 vit, dhe se në kuptim të nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, pozita përkatëse drejtuese mund të ushtrohet më ushtrues detyre vetëm 1 vit, përjashtimisht, nëse aplikohet neni 9 Ligjit Nr. 08/L-294.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk është zbatuar në tërësi Vendimi A.nr.1467/2024, i datës 29.11.2024, i KPMSHCK-së, sepse, nuk është anuluar kontrata e punës për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit e lëshuar si rezultat i konkursit të datës 07.08.2024, rithekson faktin së më Vendimin A.nr.1467/2024 të datës 29.11.2024, Këshilli ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës ankuese duke anuluar në tërësi konkursin e kontestuar si dhe çdo akt tjetër që rrjedhë nga kjo procedurë, ndërsa, ZRRE-ja përmes njoftimit me numër protokolli 006/25 të datës 13.01.2025, ka bërë anulimin e konkursit për pozitën Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit, atëherë, në këtë kuptim zbatimi i vendimit të Këshillit lidhur me çështjen përkatëse, konsiderohet i përfunduar në kuptim administrativ, ndërsa, çdo veprim tjetër i organit të punësimit jashtë njoftimit me numër protokolli 006/25, të datës 13.01.2025, bie në barrën e përgjegjësisë ligjore të organit punëdhënës.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.858/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses H.R;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Bardit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në ZRRE; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.